



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1448/ 7 prot

Datë 15.08.2024

V E N D I M
Nr. 1067/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.08.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes të ankesës së operatorit ekonomik “Klame” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-07036-05-29-2024, me objekt “*Pajisje mobilerie arsimit i mesem i pergjithshem Shkolla e Mesme Gostime Polis*”, me fond limit: 2.754.127 (dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Klame” SHPK, me NIPT K21518003F, me adresa: Rruga “Gani Kryeziu”, Nr. 23, Kodër Kamëz, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Librazhd.
Adresa: Sheshi “Gjorg Golemi”, Librazhd.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.05.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-07036-05-29-2024, me objekt “*Pajisje mobilerie arsimit mesëm i përgjithshëm Shkolla e Mesme Gostime Polis*”, me fond limit: 2.754.127 (dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

II.2. Në datën 05.06.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4166 dhe me nr. 1448/2024 protokollit, datë 05.06.2024, i operatorit ekonomik “*Klame*” SHPK, mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit me pretendimet si vijon:

I) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar: 2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë MOSTRA për artikujt ne preventiv (nga 1 cope/1 artikull). Dorëzimi i

mostrave do të bëhet ditën e hapjes së tenderit para Zyres së Protokollit të Bashkise Librazhd, ato duhet të jenë të mbyllura në kuti jo transparente të vulosur, së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bëjë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti. Mosparaqitja e të gjitha mostrave është kusht skualifikim. - Mallrat e dorëzuara të jenë sipas specifikimeve teknike të percaktuara në DST. Autoriteti kontraktor pasi të vlerësojë mostrat do t'ia kthejë operatorit ekonomik në respektim dhe në zbatim të dispozitave të LPP. Vlerësimi i mallrave të dorëzuara, mostrave do të jete kusht për vlerësimin e operatorit ekonomik. 1. Në nenin 2 Qëllimi të ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, parashikohet shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; c) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

2. Ndëkohë në nenin 3 Parime të përgjithshme të ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e percaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me kushtetutën.

3. Neni 21 pika 1 autoriteti ose enti kontraktorë i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

4. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 Kërkesat për kualifikimë i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publikë parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...] 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e

nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siá është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Në nenin 40 pika 6 germa a) Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, parashikohet shprehimisht se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e cdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

6. Shoqëria jone thekson, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithcka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt-prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit. Në përcaktimin apo vendosjen e kritereve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kritereve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në cdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

7. Per kete arsye, gjykojme, se është me vend të ndalemi në faktin nëse kjo kërkesë është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret, konstatohet se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. Për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisimit të specifikimeve teknike të produktit. Nga shqyrtimi i kritereve të kualifikimit, konstatojmë, se është kërkuar për secilin mall nga nje MOSTER. Konkretisht:

Nr	Emertimi i materialit	Njesia	Sasia	Çmimi
1	Tavolina nxenesi cikli ulet (120x64x45 cm)	copë	13	
2	Karrige nxenesi cikli ulët (35x38x37/70 cm)	copë	24	
3	Tavolina nxenesi cikli i lartë (120x75x45 cm)	copë	22	
4	Karrige nxenesi cikli lartë (35x38x42/75 cm)	copë	44	
5	Tavolina nxenesi dyvendëshe- Arsimi i Mesëm (120x45x70 cm)	copë	18	
6	Karrige nxenesi Arsimi i Mesëm (35X38X42-45/75 cm)	copë	36	
7	Tavolina mesuesi (120x60x76 cm) cikli i lartë, arsimi i mesëm	copë	12	
8	Karrige për mesues me tapiceri (510x450x780 mm)	copë	13	
9	Dollap per klasa	copë	10	
10	Derrasë e zezë (120x180 cm)	copë	13	
11	Karrige për kabinetet	copë	30	
12	Tavolina për kabinet dyshe 120x60x72 cm)	copë	14	

13	<i>Tavolina për kabinet treshe 200x60x75 cm)</i>	<i>copë</i>	9	
14	<i>Dollap për kabinetet e kimisë dhe biologjisë</i>	<i>copë</i>	2	
15	<i>Dollap për kabinetet e fizikës</i>	<i>copë</i>	2	
16	<i>Tavolina nxënësi dyvendëshe për kompjuter- Arsimi i Mesëm</i>	<i>copë</i>	8	
17	<i>Tavolina e mësuesit për kabinetin e informatikës</i>	<i>copë</i>	1	
18	<i>Karrike për nxënësit për kabinetin e informatikës</i>	<i>copë</i>	15	
19	<i>Tavolina për bibliotekë</i>	<i>copë</i>	4	
20	<i>Raft biblioteke</i>	<i>copë</i>	5	
21	<i>Karrige biblioteke</i>	<i>copë</i>	8	
22	<i>Tavolinë drejtuesi në formë L (e madhe)</i>	<i>copë</i>	1	
23	<i>Tavolinë drejtuesi në formë L (e vogël)</i>	<i>copë</i>	1	
24	<i>Karrige rrotulluese drejtuesi me rregullim lartësie</i>	<i>copë</i>	2	
25	<i>Tavolinë zyre</i>	<i>copë</i>	2	
26	<i>Raft/Dollap për zyra</i>	<i>copë</i>	2	
27	<i>Karrige zyre e thejeshte (510x450x780 mm)</i>	<i>copë</i>	4	
28	<i>Tavolinë mbledhjeje e vogel (220x80x72 cm)</i>	<i>copë</i>	1	
29	<i>Karrige për sallën e mësuesve</i>	<i>copë</i>	19	
30	<i>Portmonto për sallën e mësuesve</i>	<i>copë</i>	1	
31	<i>Raft për çdo mësues në sallën e mësuesve</i>	<i>copë</i>	2	
32	<i>Dollap garderobë për stafin</i>	<i>copë</i>	2	

33	<i>Tavolinë për sallë polifunkionale</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	
34	<i>Karrige për sallën polifunkionale</i>	<i>copë</i>	<i>3</i>	
35	<i>Dollap për arkivin (90x40x195 cm)</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>	
36	<i>Raft për infermierinë</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	
37	<i>Shtrat vizite për infermierinë</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	

8. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor, si dhe argumenteve të parashtruara nga ana jone, gjykojmë, se referuar objektit të prokurimit si dhe natyrës së produkteve që kërkohet të furnizohet, gjykojmë se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostrave për artikujt e sipërpërmendur është një kërkesë e ekzagjeruar dhe që shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, nisur nga lloji dhe natyra e mallit që kërkohet të prokurohet. Vlen të theksojmë, se qëllimi i autoritetit kontraktor, është furnizimi në kohë dhe në cilësi me produktet objekt-prokurimi, por në respekt të parimeve të ligjit për prokurimin publik, kriteret e kualifikimit të hartuara nga autoriteti kontraktor, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e kriterëve të kualifikimit autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, e cila kufizon pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi. Akoma më tej, autoriteti kontraktor ka në dispozicion edhe momentin procedural të kontrollit të dytë pas lidhjes së kontratës të përputhshmërisë së produkteve të furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'iu siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Sa me sipër, kërkojme heqjen e kriterit për paraqitjen e mostrave.

9. Akoma me tej, ne lidhje me kërkesat e autoriteteve kontraktore për paraqitjen e Mostrave, ka vendosur edhe Komisioni i Prokurimeve Publike i cili merr vendime administrativisht perfundimtare. Ne vendimin Nr.454/2024, date 07.05.2024, KPP ka arsyetuar se duhet hequr kërkesa për Mostra.

10. Nga sa me sipër analizuar si edhe bazuar në vendimin me të fundit të Komisionit të Prokurimeve Publike, kërkojme heqjen e kërkesës për paraqitjen e Mostrave.

II) Ne kriteret e vecanta të kualifikimit është kërkuar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që verteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, në fushën e perpunimit të drurit, mobilerisë sipas standardit ndërkombëtar ISO 9001 ose ekuivalent ose të perditesuar.

Operatori ekonomik duhet te paraqese nje certifikate qe verteton sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune ne fushen e perpunimit te drurit, mobilerise sipas standardit nderkombetar ISO 45001 ose ekuivalent ose te perdituesuar.

Operatori ekonomik duhet te paraqese nje certifikate qe verteton sistemin e menaxhimit te mjedisit ne fushen e perpunimit te drurit, mobilerise sipas standardit nderkombetar ISO 14001 ose ekuivalent ose te perdituesuar.

2. Se pari, kërkesa për Certifikate ISO 14001-2015-Sistemet e menaxhimit mjedisor. Kërkesat me udhëzime për përdorim është nje kerkese teresisht e pa argumentuar, pasi është nje kerkese qe nuk ka lidhje me objektin e prokurimit. Jo cdo ISO qe ekziston e publikuar ne faqet zyrtare te subjekteve te akredituara duhet te jete detyrim per shoqerite tona qe ti disponojne, pasi ato jane te kushtueshme dhe shpenzimet kuptohet qe na pengojne ne menyre te terthorte qe te marrim pjese lirisht ne gare dhe se dyti nuk është aspak e argumentuar se perse është kerkuar kjo ISO nga AK. Cfare ndotje mjedisi do ti sillte autoritetit kontraktor furnizimi me mobile dhe vendosja e tyre? Cili është impakti ne mjedis i vendosjes se mobileve neper ambienteve te caktuara nga ak?.

3. Nga ana tjeter, vlene te theksojme se shoqerite prodhuese te mobilerive, perpunimit te drurit kalojne ne disa filtra dhe me pas pajisen me leje mjedisore nga Ministria e Mjedisit dhe kerkesa qe te disponojne edhe ISO-n e referuar ne kete pike, është e tepert dhe aspak e mire argumentuar. Pra, shoqerite prodhuese te mobileve e vertetojne kete kerkese me dokumenta te tjere te njohur nga organet publike ne Rep e Shqiperise kjo ne kuptim te LPP-se. Pra, per sa kohe pajisja e e shoqerive qe operojne ne fushen e mobilerive jane te pajisura me dokumentin e Lejes se Mjedisit te leshuar nga organet shteterore Shqiptare dhe ato permbushin kerkesat minimale, perkatesisht standardet, te cilat autoriteti ose enti kontraktor i ka percaktuar ne dokumentet e tenderit, por, ne menyre tjeter, me karakteristika ose metoda te tjera teknike, te ndryshme nga ato te percaktuara me specifikimet teknike atehere nuk ka asnje arsye te vetme qe ti kufizojte operatoret vetem ne ISO.

4. Ne neni 77, pika 1 dhe 4 Kerkesat per kualifikim te ligjit 162/2020 Per Prokurimin Publik parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatoret ekonomike bazuar ne: a) pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftesine teknike dhe profesionale. Kerkesat kufizohen vetem ne ato qe jane te pershtatshme per te garantuar qe nje kandidat ose ofertues te kete kapacitetet juridike, financiare dhe aftesite teknike e profesionale per te zbatuar kontraten qe do te jepet. Te gjitha kerkesat duhet te kene lidhje dhe te jene proporcionale me objektin e kontrates. 4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojten e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne vecanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervojte qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara ne te shkuaren. Aftesia profesionale e operatoreve ekonomike per te ofruar sherbimin, punen, mallin vleresohet ne lidhje me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine,

pervojeën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Se dyti, referuar procesverbalit Per Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim, të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin Prokurimit Elektronik, është argumentuar si më poshtë: 3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë: 3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që verteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, sipas standardit ndërkombëtar ISO 9001 ose ekuivalent ose të perditesuar. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme. Në zbatim të nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 autoriteti pranon çdo certifikatë ekuivalente/ të barasvlerëshme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, neni 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik dhe nenit 39, pika dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikë, i ndryshuar.

6. Sinqerisht është qesharake kur lexon se si argument, autoriteti kërkon vetëm ISO 9001, ndërkohë në kriter kërkon tre copë IAO. Konkretisht: ISO 9001, ISO 45001 dhe ISO 14001. Pra, kemi të bëjmë me ato raste kur autoriteti vendos kritere kualifikimi teresisht në mënyrë abuzive dhe aspak të argumentuara.

7. Nga ana tjetër, si argument për vendosjen e kërkesës për ISO, autoriteti kontraktor referohet në nenin 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, që kanë të bëjnë me Kërkesa të Vecanta për Kontratat e Puneve Publike, ndërkohë që objekti i procedurës së prokurimit ka të bëjë me MALL.

8. Nga sa më sipër, kërkojmë heqjen e kërkesës për (ISO 14001:2015) si të pa argumentuar ose shtimin si alternativ edhe të dokumentit të Lejes së Mjedisit si dokument për të përmbushur kërkesën kualifikuese si edhe heqjen e kërkesës për ISO ISO 45001 si një kërkesë aspak të argumentuar.

Nga sa përshtrëam dhe analizuar më sipër, kërkojmë:

Pezullimin e procedurës deri në shqyrtimin e plotë të ankesës;

Pranimin teresisht të ankesës sipas përshtrimeve të referuara më sipër, duke hequr dhe modifikuar kriteret e vecanta të kualifikimit të ankimuar.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3, të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër referencë, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimesit.

II.4. Me shkresën nr. 1448/2 prot, datë 10.07.2024, me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik

Klame”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor Bashkia Librazhd, si më poshtë vijon:

Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike është paraqitur ankesa e operatorit ekonomik “Klame” SHPK me nr. ankimimi elektronik A/2023/4166, datë 05.06.2024, dhe nr. 1448/2024 prot, datë 05.06.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-07036-05-29-2024 me objekt “Pajisje mobilerie arsimit i mesem i përgjithshëm Shkolla e Mesme Gostime Polis”, me vlerë të pritshme të kontratës 2 754 127 (dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 12.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), ankesën e plotë të ankimuesit i cili kërkon modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

Referuar nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”.

Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dërguar asnjë informacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin e sipërcituar, për vënien në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike së bashku me procesverbalet e argumentuara për secilin

kriter kualifikimi dhe specifikim teknik, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Klame” SHPK.

II.5. Me shkresën nr. 1448/3 prot, datë 01.08.2024, me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Klame”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor Bashkia Librazhd, si më poshtë vijon:

Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike është paraqitur ankesa e operatorit ekonomik “Klame” SHPK me nr. ankimimi elektronik A/2023/4166, datë 05.06.2024, dhe nr. 1448/2024 prot, datë 05.06.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-07036-05-29-2024 me objekt “Pajisje mobilerie arsimit mesëm i përgjithshëm Shkolla e Mesme Gostime Polis”, me vlerë të pritshme të kontratës 2 754 127 (dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 12.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), ankesën e plotë të ankimuesit i cili kërkon modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

Referuar nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”.

Me shkresën me nr. 1448/2 prot., datë 10.07.2024 me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Klame” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoj autoritetit kontraktor të dërgojë pranë KPP-së, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriteve të

veçanta për kualifikim, specifikimeve teknike si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Klame” SHPK.

Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dërguar asnjë informacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin e sipërcituar, për vënien në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, ky Komision përsërit kërkesën që autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, specifikimeve teknike si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Klame” SHPK.

Për sa më sipër, kërkojmë respektimin me rigorozitet të kërkesës tonë, pasi në rast të kundërt, do të aplikohen masat përkatëse në zbatim të nenit 131 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin parashikohet se “Refuzimi i autoritetit ose entit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Agjencinë e Prokurimit Publik ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë”.

II.6. Me shkresën nr. 3786 prot, datë 08.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 1448/4 prot, datë 12.08.2024, me objekt “Informacion për procedurën Pajisje mobilerie arsimit i mesem i përgjithshëm Shkolla e Mesme Gostime Polis”, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Klame” SHPK, dhe ka vendosur pranimin e saj me argumentat si vijon:

Te nderuar,

Ne pergigije te shkreses suaj me nr. 1448/3prot date 01.08.2024 ne lidhje me proceduren me objekt “Pajisje mobilerie arsimit i mesem i përgjithshëm “Shkolla e Mesme Gostime Polis” ju bejme me dije se:

Mbeshtetur ne ligjin nr. 162, date 23.12.2023 “Per Prokurimin Publik” i ndyshuar pas administrimit te ankeses per tenderin me objekt “Pajisje mobilerie arsimit i mesem i përgjithshëm “Shkolla e Mesme Gostime Polis” me nr. REF: 13440-07-17-202 4 dhe fond limit 2.754.127 (dy milion e shtateqind e pesedhjetë e kater mije e neqind e njezet e shtate) leke pa tvsh mberritur prane Bashkise Librazhd eshte kryer shqyrtimi i saj konform percaktimeve dhe procedurave te bazes ligjore te siperpermendur.

Me mberritjen e ankeses prane AK eshte urdheruar ngritja e komisionit per shqyrtimin e ankeses dhe pezullim te procedures se prokurimit.

*Nga sa me sipër konkludohet;
Ankesa është hartuar sipas formularit standart të percaktuar në DT.*

Ankesa është paraqitur brenda afatit të percaktuar në Ligjin e Prokurimeve.

*Në këtë ankesë, pretendohet se kriteret e vendosura nga AK janë në kundërshtim me
percaktimet e LPP dhe RRPP.*

*Komisioni i shqyrtimit të ankesave pasi shqyrtoi kërkesën e operatorit ekonomik dhe nisur nga
nevoja emergjente për mobilimin e shkolles së re Polis për të mos vonuar procesin e
prokurimit vendos të pranojë ankesën e Operatorit Ekonomik.*

Procedura është rihedhur perseri me kriteret e reja dhe është në proces.

Bashkëngjitur do të gjeni dokumentat e procedurës së prokurimit.

- 1. Urdher Prokurimi (2 faqe).*
- 2. Specifikimet teknike (21 faqe).*
- 3. Procesverbal argumentimi (6 faqe).*
- 4. Dokumentat standarte të tenderit (102 faqe).*

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si
dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik “Klame” SHPK, në
zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë
13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të
Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda
objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përrjashtimisht, kur ka lidhje midis
objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë
procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur dhe nga
pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet
fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i
ankesës ka lidhje me veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit
të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Klame” SHPK, për sa i
përketë kundërshtimit të kriterëve kualifikues me arsyet: “se autoriteti kontraktor duhet të
heqë kriterin në lidhje me dorzimin e mostrave objekt prokurimi dhe heqjen e ISO heqjen e
ISO 45001 dhe ISO 1400:2015 ose shtimin si alternativ edhe të dokumentit të Lejes së

Mjedisit për të përmbushur kërkesën kualifikuese, si kërkesa aspak të argumentuara”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.2. Në datën 30.05.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-07036-05-29-2024, me objekt “*Pajisje mobilerie arsimit i mesem i pergjithshem Shkolla e Mesme Gostime Polis*”, me fond limit: 2.754.127 (dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

III.1.3. Në datën 05.06.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4166 dhe me nr. 1448/2024 protokollin, datë 05.06.2024, i operatorit ekonomik “*Klame*” SHPK, mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit.

III.1.4. Bazuar në nenin 112 pika 3, të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

III.1.5. Me shkresën nr. 1448/2 prot, datë 10.07.2024, me objekt “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Klame*”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor Bashkia Librazhd, duke i kërkuar informacion dhe dokumentacion në lidhje me procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III.1.6. Me shkresën nr. 1448/3 prot, datë 01.08.2024, me objekt “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Klame*”, Komisioni i Prokurimit Publik iu ridrejtua sërish autoritetit kontraktor Bashkia Librazhd, duke i kërkuar informacion dhe dokumentacion në lidhje me procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke i sjellë në vëmendje se në rast mos bashkëpunimi me Komisionin e Prokurimit Publik do të merren masat përkatëse në zbatim të nenit 131 të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”.

III.1.7. Me shkresën nr. 3786 prot, datë 08.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 1448/4 prot, datë 12.08.2024, me objekt “*Informacion për procedurën Pajisje mobilerie arsimit i mesem i pergjithshem Shkolla e Mesme Gostime Polis*”, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “*Klame*” SHPK, dhe ka vendosur pranimin e saj me argumentat si vijon:

Ne pergigije te shkreses suaj me nr. 1448/3prot date 01.08.2024 ne lidhje me proceduren me objekt “Pajisje mobilerie arsimit i mesem i pergjithshem “Shkolla e Mesme Gostime Polis” ju bejme me dije se: Mbeshtetur ne ligjin nr. 162, date 23.12.2023 “Per Prokurimin Publik” i

ndyshuar pas administrimit te ankeses per tenderin me objekt "Pajisje mobilerie arsimi i mesem i pergjithshem "Shkolla e Mesme Gostime Polis" me nr. REF: 13440-07-17-202 4 dhe fond limit 2.754.127 (dy milion e shtateqind e pesedhete e kater mije e njeqind e njezet e shtate) leke pa tvsh mberritur prane Bashkise Librazhd eshte kryer shqyrtimi i saj konform percaktimeve dhe procedurave te bazes ligjore te siperpermendur. Me mberritjen e ankeses prane AK eshte urdheruar ngritja e komisionit per shqyrtimin e ankeses dhe pezullim te procedures se prokurimit. Nga sa me siper konkludohet; Ankesa eshte hartuar sipas formularit standart te percaktuar ne DT. Ankesa eshte paraqitur brenda afatit te percaktuar ne Ligjin e Prokurimeve. Ne kete ankesa, pretendohet se kriteret e vendosura nga AK jane ne kundërshtim me percaktimet e LPP dhe RRPP.

Komisioni i shqyrtimit te ankesave pasi shqyrtoi kerkesen e operatorit ekonomik dhe nisur nga nevoja emergjente per mobilimin e shkolles se re Polis per te mos vonuar procesin e prokurimit vendos te pranoje ankesen e Operatorit Ekonomik. Procedura eshte rihedhur perseri me kriteret e reja dhe eshte ne proces. Bashkengjitur do te gjeni dokumentat e procedures se prokurimit. 1. Urdher Prokurimi (2 faqe); 2. Specifikimet teknike (21 faqe); 3. Procesverbal argumentimi (6 faqe); 4. Dokumentat standarte te tenderit (102 faqe).

III.1.8. Komisioni Prokrimit Publik duke marrë shkasë nga kthim përgjigjia e sipërcituar, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike nga ku rezultoi se autoriteti kontraktor Bashkia Librazhd procedurën e prokurimit objekt ankime pikë së pari nuk e ka pezulluar pas ardhjes së ankesës në respektim të pikës 2 të nenit 112 të LPP, ndërkohë që ka vijuar duke anuluar procedurën objekt shqyrtimi në SPE si më poshtë vijon pa vënë në dijeni Komisioni e Prokurimit Publik dhe operatorin ekonomik ankimues dhe ka publikuar procedurën e re me të njëjtin fond limit dhe me të njëjtin objekt prokurimi.

Objekti i tenderit: "Pajisje mobilerie arsimi i mesem i pergjithshem "Shkolla e Mesme Gostime Polis"

Autoriteti Kontraktues: Bashkia Librazhd | Data e hapjes: 30-05-2024 Ora : 11:00 | Data e mbylljes: 12-06-2024 Ora : 09:00 | Numri i referencës: REF-07036-05-29-2024 | Fondi limit: 2,754,127.00 Lekë | Me lote: Jo | Anulluar: Po | Pezulluar: Jo

Njoftimet

Numër	Subjekt	Përshkrim	Publikuar	Data e Publikimit
Contract Notice				
CN/81272/05292024	"Pajisje mobilerie arsimi i mesem i pergjithshem "Shkolla e Mesme Gostime Polis"	njoftim kontrate	Po	5/30/2024 10:09:30 AM
Cancellation Notice				
CN/04701/07162024	"Pajisje mobilerie arsimi i mesem i pergjithshem "Shkolla e Mesme Gostime Polis"	njoftim anulimi	Po	7/17/2024 2:14:01 PM
CN/03949/07152024	"Pajisje mobilerie arsimi i mesem i pergjithshem "Shkolla e Mesme Gostime Polis"	njoftim anulimi	Jo	

Objekti i tenderit: "Pajisje mobilerie arsimi i mesem i pergjithshem "Shkolla e Mesme Gostime Polis"

Autoriteti Kontraktues: Bashkia Librazhd | Data e hapjes: 18-07-2024 Ora : 15:30 | Data e mbylljes: 31-07-2024 Ora : 09:00 | Numri i referencës: REF-13440-07-17-2024 | Fondi limit: 2,754,127.00 Lekë | Me lote: Jo | Anulluar: Jo | Pezulluar: Jo

III.1.9. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.10. Në nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni.

Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.

3. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, e publikon në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të paktën të dhëna për:

- a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;
- b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

4. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

- a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit;

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;

c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.

III.1.11. Në nenin 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.12. Në nenin 118 “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranohet ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulohet plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.

3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

b) të urdhërojë autoritetin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj;

c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji.

Sa më sipër, KPP gjykon, se veprimet proceduriale të ndërmarra nga autoriteti kontraktor Bashkia Librazhd janë kryer në shkelje të parashikimeve ligjore aktualisht në fuqi dhe se zyrtari/ët përgjegjës të këtij autoriteti kontraktor kanë kryer shkelje të rregullave të prokurimit publik. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të kishte të kishte zbatuar detyrimet që burojnë nga neni 112 dhe 114 të LPP, ku fillimisht duhet të pezullonte procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe më pas të shqyrtonte ankesën e operatorit ekonomik ankimues duke vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik dhe operatorin ekonomik ankimues brënda afateve të përcaktuara në dispozitat e sipërcituara. KPP veprimin e datës 17.07.2024 të autoritetit kontraktor në lidhje me anulimin e procedurës e gjen, jo në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. KPP i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi. Duke marrë shkas nga konstatimet e sipërcituara, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor nëpërmjet veprimeve të tij, ka vepruar në kundërshtim të plotë me rregullat e prokurimit publik. Në nenin 21 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet, se “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj”, duke mos garantuar dhe

respektuar parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. KPP thekson, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efikasitetit të parashikuar në nenin 2 të LPP-së.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Klame” ShPK, ku kërkon: *“Heqjen e paraqitjes së mostrave dhe heqjen e ISO 45001 dhe ISO 1400:2015 ose shtimin si alternativë edhe të dokumentit të Lejes së Mjedisit për të përmbushur kërkesën kualifikuese, si kërkesa aspak të argumentuara”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3.4 dhe 3 të “Kapacitetit Teknik” të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, autoriteti kontraktor, ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostra për artikujt në preventiv (nga 1 cope/1 artikull) . Dorëzimi i mostrave do të bëhet ditën e hapjes së tenderit para Zyres së Protokollit të bashkisë Librazhd, ato duhet të jenë të mbyllura në kuti jo transparente të vulosur, së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bëjë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti. Mosparaqitja e të gjitha mostrave është kusht skualifikim.

- *Mallrat e dorezuara të jenë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST. Autoriteti kontraktor pasi të vlerësojë mostrat do tja kthejë operatorit ekonomik në respektim dhe në zbatim të dispozitave të LPP . Vlerësimi i mallrave të dorezuara , mostrave do të jetë kusht për vlerësimin e operatorit ekonomik.*

3. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

- a. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që verteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, në fushën e përpunimit të drurit, mobilerisë sipas standardit ndërkombëtar ISO 9001 ose ekuivalent ose të perditesuar.*
- b. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që verteton sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë në fushën e përpunimit të drurit, mobilerisë sipas standardit ndërkombëtar ISO 45001 ose ekuivalent ose të perditesuar.*
- c. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që verteton sistemin e menaxhimit të mjedisit në fushën e përpunimit të drurit, mobilerisë sipas standardit ndërkombëtar ISO 14001 ose ekuivalent ose të perditesuar.*

III.2.2. Me shkresën nr. 3786 prot, datë 08.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 1448/4 prot, datë 12.08.2024, me objekt *“Informacion për procedurën Pajisje mobilerie arsimit i mesëm i përgjithshëm Shkolla e Mesme Gostime Polis”*, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Klame” SHPK, dhe ka vendosur pranimin e saj me argumentat si vijon:

Te nderuar,

Ne pergigije te shkreses suaj me nr. 1448/3prot date 01.08.2024 ne lidhje me proceduren me objekt "Pajisje mobilerie arsimi i mesem i pergjithshem "Shkolla e Mesme Gostime Polis" ju bejme me dije se:

Mbeshtetur ne ligjin nr. 162, date 23.12.2023 "Per Prokurimin Publik" i ndyshuar pas administrimit te ankeses per tenderin me objekt "Pajisje mobilerie arsimi i mesem i pergjithshem "Shkolla e Mesme Gostime Polis" me nr. REF: 13440-07-17-202 4 dhe fond limit 2.754.127 (dy milion e shtateqind e pesedhete e kater mije e njeqind e njezet e shtate) leke pa tvsh mberritur prane Bashkise Librazhd eshte kryer shqyrtimi i saj konform percaktimeve dhe procedurave te bazes ligjore te siperpermendur.

Me mberritjen e ankeses prane AK eshte urdheruar ngritja e komisionit per shqyrtimin e ankeses dhe pezullim te procedures se prokurimit.

Nga sa me siper konkludohet;

Ankesa eshte hartuar sipas formularit standart te percaktuar ne DT.

Ankesa eshte paraqitur brenda afatit te percaktuar ne Ligjin e Prokurimeve.

Ne kete ankesa, pretendohet se kriteret e vendosura nga AK jane ne kundersizim me percaktimet e LPP dhe RRPP.

Komisioni i shqyrtimit te ankesave pasi shqyrtoi kerkesen e operatorit ekonomik dhe nisur nga nevoja emergjente per mobilimin e shkolles se re Polis per te mos vonuar procesin e prokurimit vendos te pranoje ankesen e Operatorit Ekonomik.

Procedura eshte rihedhur perseri me kriteret e reja dhe eshte ne proces.

Bashkengjitur do te gjeni dokumentat e procedures se prokurimit.

- 1. Urdher Prokurimi (2 faqe).*
- 2. Specifikimet teknike (21 faqe).*
- 3. Procesverbal argumentimi (6 faqe).*
- 4. Dokumentat standarte te tenderit (102 faqe).*

III.2.3. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: "Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera".

III.2.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në thelb, janë heqje të kriterëve kualifikuese përsa ipërket pikës 2.3.4 dhe pikës 3 të kapaciteit teknik. Komisioni Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik si më sipër cituam, rezulton, se i ka pranuar pretendimet e ngritura nga ankimuesi në ankesë, ndaj dhe do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këto pretendime të operatorit ekonomik ankimues.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyll çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Klame” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, Loti 1 me Nr. REF-02362-04-23-2024, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme për autoritetet dhe entet kontraktore qendrore”, me fond limit: 47,714,964 (dyzet e shtatë milion e shtatëqind e katërbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose 473,221.89 Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë, datë 23.4.2024, është 100.83 lekë, me afat të marrëveshjes kuadër 4 (katër) vite, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik, nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, për shkeljet e kryera nga të gjithë zyrtarët përgjegjës.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimues “Klame” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

